



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË PUNËS TË KZAZ DHE GNV,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QERVERISJES VENDORE,
TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratimin e Manualit të Punës së KZAZ dhe GNV, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 21, pika 9, Neni 23/1, pika a të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi materialin e paraqitur, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike, mbi përmbajtjen e Manualit të Punës së KZAZ dhe GNV, i cili do të trajtohet në funksion të trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GNV-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës të përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, do të organizojë kurse dhe sesione trajnimi për anëtarët e KZAZ-ve dhe GNV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Nr.800 i Vendimit Data 6.6.2019 e Vendimit Ora 19.³⁰e Vendimit

Për miratimin e Manualit të Punës së KZAZ dhe GNV,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Manuali i Punës së KZAZ dhe GNV shpjegon të gjitha hapat kyç që duhen ndjekur në fazat e procesit të numërimit të votave, duke filluar nga rregullimi i vendit të numërimit të votave, teknologjia mbështetëse e numërimit të votave, të drejtat e detyrat e vëzhguesve, marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga grupet e marrjes në dorëzim, procesi i numërimit të votave, vlerësimi i fletëve të votimit [vota të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara], numërimi i votave për subjektet [për kandidatët për kryetar bashkie, këshillin bashkiak] deri në nxjerrjen dhe transmetimin e rezultateve të çdo ZAZ-je, si dhe dhe përgjegjësitë e sanksionet për anëtarët e KZAZ-ve dhe GNV-ve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, shkronja "a", e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Manualin e Punës të KZAZ dhe GNV, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement ZGURI -	Kryetar
Denar BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar SKËNDERI-	Anëtar
Edlira JORGAQI-	Anëtare
Rezarta BITRI-	Anëtare



Nr.800 i Vendimit Data 6.6.2019 e Vendimit Ora 19.³⁰e Vendimit

Për miratimin e Manualit të Punës së KZAZ dhe GNV,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019